

VENDIM
Nr. 61, datë 7.7.2014

**MBI DISA NDRYSHIME DHE SHTESA TË RREGULLAVE TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE
TË INTERKONJEKSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, kapitullit 11, të Rregullave të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksioneve, miratuar me vendimin nr. 13, datë 22.2.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupit të punës në lidhje me propozimin e OST sh.a., për disa ndryshime dhe shtesa të rregullave të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksioneve" të miratuar me vendimin nr. 13 datë 22.2.2011.

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e OST sh.a. sipas ndryshimeve bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.9.2014.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

ANKANDET DITORE NË PIKËN 5.1 DO TË JENË SI MË POSHTË:

"Ankandi ditor

Kapaciteti disponibël ditor, për çdo kufi dhe drejtim, për ditën D, përbëhet nga shuma e kapacitetit të paalokuar në ankandin përkatës mujor, me kapacitetin "e kthyer" të deklaruar nga pjesëmarrësit përkatës që nuk do të përdoret në ditën D.

Procedura e llogaritjes dhe e alokimit të kapacitetit transmetues ditor është:

- Deri në orën 10:00 të çdo dite, pjesëmarrësit e tregut që kanë fituar të drejtën e transmetimit në ankandin vjetor/mujor, duhet të deklarojnë sasinë e kapacitetit në MW, veçmas për çdo kufi e drejtim, që kanë planifikuar të përdorin në ditën D+2.

- Deri në orën 11:00 të çdo dite, OST-ja publikon në faqen e vet të internetit, dhe njofton pjesëmarrësit e tregut për kapacitetin disponibël për ditën D+2, për çdo kufi e drejtim, si dhe shkëmben informacionin përkatës me TSO-të fqinje lidhur me kapacitetin "e kthyer" dhe atë disponibël për ditën D+2.

- Në intervalin 12:00-14:00 të çdo dite, OST-ja zhvillon procedurën e ankandit, duke pranuar në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës NOVITA kërkesat e pjesëmarrësve të tregut për kapacitet transmetuese për ditën D+2, në përputhje me njoftimin përkatës të bërë nga ana e saj.

- Deri në orën 15:00 të çdo dite, OST-ja bën alokimin e kapacitetit, përcaktimin e fituesve dhe të çmimit të ankandit, sipas së njëjtës procedurë që ndiqet aktualisht nga OST-ja në ankandet vjetore/mujore, për çdo kufi dhe drejtim të fluksit, dhe njofton pjesëmarrësit për kapacitetin respektiv që i është alokuar për ditën D+2.

- Procedura e alokimit ditor për ditën e diel, të hënë dhe të martë realizohet ditën e enjte. Nëse dita D është ditë pushimi zyrtar, procedura zhvillohet në ditën e punës pararendëse.

Fatura për ankandin ditor do të përgatitet në baza mujore në mbyllje të muajit gjatë së cilës është përdorur kapaciteti. PAGESA e faturës bëhet në bazë të procedurës së pagesës së shërbimit të transmetimit. OST sh.a. ka të drejtë të prekë garancinë bankare të regjistrimit në treg në rast mospagese të faturës mujore dhe nëse sasia e garancisë bankare nuk mbulon pagesën e përdorimit të kapacitetit të përjashtojë pjesëmarrësin në ankandin ditor deri në përmbushjen e detyrimit financiar kundrejt OST sh.a.".